

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1896 Prot.

Durrës, më 14.08.2025

VENDIM

Nr. 87, datë 14.08.2025
PËR

"MIRATIMIN PARAPRAK TË PLANIT BUXHETOR AFATMESËM (PBA), PËR PERIUDHËN 2026-2028, PËR UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Vendim. Nr. 75, Datë 12.2.2018 "Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor"; Udhëzimit të Përbashkët Nr. 20, Datë 20.9.2019 të MASR dhe MFE "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor"; Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 të Ministrisë së Financave "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"; Urdhërit nr.4, datë 26.01.2024 të Ministrisë së Financave "Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit"; Shkresës së MAS administruar në UAMD me nr.1776 prot., datë 21.07.2025; referuar shkresës nr.1488 prot., datë 12.06.2025, shkresës së FB nr.1488/1 prot., datë 10.07.2025; shkresës së FSP nr.1488/2 prot., datë 15.07.2025; shkresës së FE nr.1488/3 prot., datë 18.07.2025; shkresës së FTI nr.1522/1, prot., datë 10.07.2025; shkresës së QKZHE nr. 1487/3 prot., datë 22.07.2025; shkresës së Dr. së Teknologjisë së Informacionit nr.1487/4 prot., datë 22.07.2025; shkresës së Sektorit të Bibliotekës nr. 1487/2 prot., datë 18.07.2025; shkresës së Dr. Juridike nr.1487/1 prot., datë 10.07.2025; Vendimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) nr. 1, datë 12.08.2025 për "Miratimin e draft planit buxhetor afatmesëm (PBA), për periudhën 2026-2028, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës"; si dhe relacionit dhe tabelave përcjellë nga Drejtoria e Administrimit Financiar (bashkëlidhur); Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të planit buxhetor afatmesëm (PBA), për periudhën 2026-2028, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas tabelave të Aneksit 7 A, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

